



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 6

4 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr.2/2013 datë 31.1.2013	Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013..... 141
Vendim i KM nr. 29, datë 24.1.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Kryeministrinë..... 141
Vendim i KM nr. 30, datë 24.1.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare..... 142
Vendim i KM nr. 42, datë 23.1.2013	Për miratimin e fondit të shpenzimeve për Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2013..... 142
Vendim i KM nr. 43, datë 23.1.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme..... 143
Vendim i KM nr. 45, datë 23.1.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e shpenzimeve administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen “Burimi S.R.L. & Eagle Games sh.a. kundër Republikës së Shqipërisë”..... 144
Vendim i KM nr. 47, datë 23.1.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 45, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, të ndryshuar..... 144
Vendim i KM nr. 48, datë 23.1.2013	Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)..... 145
Vendim i KM nr. 49, datë 23.1.2013	Për dhënie ndihme financiare familjes së të ndjerit Musa Bajram Skura, ish-punonjësi i Policisë së Shtetit, vrarë në krye të detyrës... 147

**VENDIM
Nr. 2/2013**

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË MANDATEVE PËR ÇDO ZONË ZGJEDHORE TË
ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2013**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 76 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në përfundim të procedurave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, referuar me shkresën nr. 174 prot., datë 11.1.2013,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Caktohet numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore, si më poshtë:

Zona zgjedhore qarku Berat	8 (tetë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Dibër	6 (gjashtë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Durrës	13 (trembëdhjetë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Elbasan	14 (katërbëdhjetë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Fier	16 (gjashtëmbëdhjetë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Gjirokastrë	5 (pesë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Korçë	12 (dymbëdhjetë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Kukës	4 (katër)	mandate
Zona zgjedhore qarku Lezhë	7 (shtatë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Shkodër	11 (njëmbëdhjetë)	mandate
Zona zgjedhore qarku Tiranë	32 (tridhjetë e dy)	mandate
Zona zgjedhore qarku Vlorë	12 (dymbëdhjetë)	mandate

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratuar në datën 31.1.2013

**VENDIM
Nr. 29, datë 24.1.2013**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
KRYEMINISTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekësh, për përbalimin e shpenzimeve për shërbime të lobimit, me qëllim kryesor identifikimin dhe tërheqjen e financimeve shtetërore dhe private në fusha me interes për Shqipërinë nga agjenci të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga vende të tjera të botës, si dhe agjenci të tjera ndërkombëtare.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 30, datë 24.1.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR DREJTORINË
E SHËRBIMEVE QEVERTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi prej 48 802 075 (dyzet e tetë milionë e tetëqind e dy mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekësh, për rikonstrukcionin e plotë të vilës nr. 4 në Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshilli të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 42, datë 23.1.2013

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË
RADIO DHE TELEVISIONIT, PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), për vitin 2013, për shumën 108 100 000 (njëqind e tetë milionë e njëqind mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

Pasqyra nr.1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2013

Në milionë lekë

Nr.	EMËRTIMI	
1	Paga dhe sigurime shoqërore	58.5
2	Honorarë	3.5
3	Materiale e shërbime	5.5
4	Shërbime nga të tretët e transport	8.5
5	Shërbime udhëtimi, dieta e kuota	6.0
6	Shpenzime për mirëmbajtjen	1.0
7	Shërbime të tjera	1.0
8	Detyrime dhe kompensime legale	4.0
9	Projekt SEE TV DIGI	0.1
10	Shpenzime për konferenca rajonale dhe kombëtare	2.0
11	Organizimi i fushatës për informimin e publikut	13.0
12	Investime	5.0
	TOTALI	108.1

VENDIM

Nr. 43, datë 23.1.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E PUNËVE TË JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime korente”, t’i shtohet fondi prej 100 000 (njëqind mijë) USD, për t’ia dhënë qeverisë turke si ndihmë humanitare për përballimin e kostove të strehimit të refugjatëve sirianë.

2. Ekuivalenti në lek i shumës së përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2013.



3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 45, datë 23.1.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË
ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR PËR ÇËSHTJEN “BURIMI S.R.L. & EAGLE GAMES
SHA KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e vitit 2013, t’i shtohet fondi 50 000 (pesëdhjetë mijë) USD, për të përballuar shpenzimet administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen “Burimi s.r.l. & Eagle Games sh.a. kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve nga Investimet (ISCID).

2. Fondi 50 000 (pesëdhjetë mijë) USD, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 47, datë 23.1.2013

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 45, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK NË
MËNYRË ELEKTRONIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit nr. 45, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të zhvillohen me mjete elektronike, me përjashtim të rasteve emergjente dhe prokurimeve me vlerë nën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 48, datë 23.1.2013

PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË (UMT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 9, 12,12/1, 41, 76 e 77, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Krijimi dhe misioni i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)

1. Krijohet Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (në vijim UMT), si institucion publik i arsimit të lartë.

2. UMT-ja ka për mision:

a) ofrimin e formimit universitar të studentëve dhe specialistëve në të tria ciklet e studimeve në shkencat e shëndetit;

b) ofrimin e kualifikimit të specialistëve në fushën e shëndetit;

c) thellimin e kualifikimit të punonjësve akademikë e shkencorë universitarë;

ç) kryerjen e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar;

d) realizimin e funksioneve diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, nëpërmjet shërbimeve, që janë njësi bazë të universitetit dhe pjesë përbërëse e strukturës së qendrave spitalore universitare.

3. Nga Universiteti i Tiranës shkëputen dhe integrohen në strukturën e UMT-së njësitë kryesore të mëposhtme:

a) Fakulteti i Mjekësisë;

b) Fakulteti i Infermierisë.

II. Struktura e UMT-së

Në strukturën e UMT-së përfshihen njësitë kryesore, si më poshtë vijon:

a) Fakulteti i Mjekësisë;

b) Fakulteti i Mjekësisë Dentare;

c) Fakulteti i Farmacisë;

ç) Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

d) Fakulteti i Shëndetit Publik.

III. Programet e studimeve të UMT-së

UMT-ja ofron të gjitha programet e studimeve universitare në të tria ciklet e studimit që ka ofruar deri tani Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Infermierisë, i Universitetit të Tiranës, dhe çdo program tjetër, të miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.



IV. Organet dhe autoritetet drejtuese të UMT -së

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të zgjedhura për strukturat e Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, vazhdojnë mandatet e tyre në organet dhe autoritetet drejtuese të njëjsteve të reja kryesore të UMT-së, në të cilat janë përfshirë njësitë bazë, ku ata janë zgjedhur. Në organet kolegjiale drejtuese të Fakultetit të Shëndetit Publik marrin pjesë edhe përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik, sipas përcaktimeve të statutit të universitetit dhe rregullores së fakultetit.

2. Autoritetet drejtuese të UMT-së janë:

- a) rektori;
- b) dekanët e fakulteteve;
- c) përgjegjësit e departamenteve.

3. Rektori emërohet sipas pikës 2 të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Organet dhe autoritetet drejtuese të zgjedhura të strukturave ekzistuese funksionojnë në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me statutin e UMT-së.

5. Autoritetet dhe organet e tjera drejtuese emërohen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 23, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. Organika dhe financimi:

1. Organika e UMT-së përmban numrin e punonjësve të Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Infermierisë që integrohen në të dhe që janë përfshirë në numrin total të punonjësve për Universitetin e Tiranës, nga i cili shkëputen njësitë kryesore të sipërpërmendura.

2. Financimi i UMT-së, për vitin 2013, përbëhet nga:

a) buxheti i Universitetit të Tiranës, i planifikuar për Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Infermierisë;

b) burime të tjera të ligjshme.

3. UMT-së i kalojnë të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që zotërojnë dhe disponojnë Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Infermierisë, të Universitetit të Tiranës.

4. UMT-ja e ka selinë në Tiranë, në godinën e Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës.

5. UMT-ja e fillon veprimtarinë për vitin akademik 2012 - 2013.

6. Marrëdhëniet institucionale ndërmjet UMT-së dhe qendrave spitalore universitare e Institutit të Shëndetit Publik rregullohen sipas kuadrit ligjor në fuqi.

7. Personeli me grada shkencore dhe tituj akademikë i Institutit të Shëndetit Publik e zhvillon veprimtarinë kërkimore - shkencore dhe angazhohet në procesin e mësimdhënies në kuadër të UMT-së.

VI. Dispozitë e fundit

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 49, datë 23.1.2013

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË TË NDJERIT MUSA BAJRAM
SKURA, ISH-PUNONJËS I POLICISË SË SHTETIT, VRARË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për familjen e të ndjerit Musa Bajram Skura, ish-punonjës i Policisë së Shtetit, vrarë në krye të detyrës.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 4.2.2013
Doli nga shtypi më 4.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 10 lekë